VENDIM
Nr. 31/2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 5/2015, "PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 5/2015, "Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

I. Deputetja Vasilika Hysi caktohet Kryetare në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në vend të deputetit Fatmir Xhafaj.

II. Deputeti Besnik Baraj caktohet Kryetar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin në vend të deputetit Eduart Shalsi.

III. Deputeti Ulsi Manja caktohet sekretar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në vend të deputetes Vasilika Hysi.

IV. Deputeti Blendi Klosi caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Valentina Leskaj

Miratuar në datën 23.3.2017